



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1

Replika në distancë/Rama sjell kontrollorë nga Turqia e Greqia, Meta acarohet: Shqiptarët janë zot në vendin e vet! Historia e Rinasit e sajuar për të më provokuar mua

2

Hapet brenda pak ditësh, Rama publikon pamje dhe tregon si do quhet aeroporti i Kukësit

3

Rama: Puna në Rinas rinisi me kontrollorët turq, nesër rryn edhe grupi nga Greqia! Një pjesë e kontrollorëve tanë janë rikthyer në punë

4

Valentina Lile

5

COVID meirr tjetër jetë nga radhet e bluzave të bardha në Tiranë, humb jetën mjekja endokrinologe

5

'Njeri që s'ngopej me gjakun e të pafajshmëve! E bija e ish të burgosurit politik letër të hapur Metës: Terhiqeni dekoratën e turpit që i dhate Mehdi Bushatit

Aktualitet

Lushnje/ Shpërthim me tritol në dyqanin e Arjan Aliços, ish-anëtar i bandës së Aldo Bares, i dënua për tentativë vrasje së bashku me të birin

Një shpërthim me tritol ka ndodhur në orët e para të mëngjesit në Lushnje. Sasia e lëndës plasëse është vënë në dyqanin e Arjan Aliços, një person me precedent të theksuar kriminal.

Një shpërthim me tritol ka ndodhur në orët e para të mëngjesit në Lushnje. Sasia e lëndës plasëse është vënë në dyqanin e Arjan Aliços, një person me precedent të theksuar kriminal, i njohur edhe si ish-anëtar i bandës së Aldo Bares.

Në ambientin ku është vendosur tritoli, më parë ka shërbyer si lokal dhe është dëmtuar vetëm pjesa e jashtme e qepenit. Pronari i lokalit Arjan Aliço, aktualisht ndodhet në burg i dënua për tentativë vrasje së bashku me të birin, ndërsa pjesëtarët e tjerë të familjes nuk banojnë aty prej vitesh. Aktualisht tek zona ku ndodhet dyqani nuk ka kamera sigurie dhe këtu nuk ka biznese, pasi ndodhen vetëm disa dyqane të vogla.



Në vitin 2016, Arjan Aliço në bashkëpunim me djalin e tij Xhino Aliço, kanë plagosur me thikë dhe sende të forta, personin me inicialet J. S., duke i shkakuar atij dëmtime të rënda në trup dhe në kokë.

Policia sakaq ka nisur hetimet për të identifikuar personin që e ka vendosur dhe për të zbardhur ngjarjen.

'Rreth orës 03:25, në lagjen "Skënder Libohova" Lushnjë, në derën e jashtme të një ambienti që ka shërbyer më parë si dyqan, në pronësi të shtetasit Arjan Aliço, ka shpërthyer një sasi e vogël e dyshuar lëndë plasëse. Policia njofton se për pasojë është dëmtuar vetëm dera (qepeni) i këtij ambienti. Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë Lushnjë po vijon punën për zbardhjen e ngjarjes, identifikimim dhe kapjen e autorëve.'- njofton policia.



Ora 08:55

I vendosën tritol në dyqan, Arjan Aliço i dënua për tentativë vrasje së bashku me të birin (VIDEO)

Arjan Aliço, pronari i dyqanit, të cilit mëngjesin e sotëm i vendosën tritol, është i dënua për tentativë vrasje.

Në vitin 2016, Arjan Aliço në bashkëpunim me djalin e tij Xhino Aliço, kanë plagosur me thikë dhe sende të forta, personin me inicialet J. S., duke i shkakuar atij dëmtime të rënda në trup dhe në kokë.

Arjan Aliço u arrestua menjëherë pas ngjarjes, ndërsa i biri, Xhino Aliço u shpall në kërkim. Ngjarja ndodhi pas një konflikti për motive të dobëta, në një pikë bastesh.

Xhino Aliço, djali i tij 28-vjeç, **u ekstradua** nga Kroacia pak ditë më parë pasi rezultoi i dënua me 13.6 vite burg për tentativë vrasje.

28-vjeçari është dënua më 10.03.2020 me 13 vjet e 6 muaj burg nga Gjykata e Lushnjës, për një ngjarje të ndodhur në vitin 2016.

M.Q./r.k./Shqiptarja.com

TAG: shperthim lende plasese lushnje Arjan Aliço

Ndalohe

reptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

Sondazhi i ditës:

A ju janë ofruar para ose favore në këmbim të votës në zgjedhjet e 25 prillit?

Po

Jo

Nuk kam përgjigje

Komento

Lajme të tjera

Aktualitet

Shoqërohet në polici ish-drejtori i Aviacionit Civil, Petrit Sulaj

8 Prill, 21:57

Aktualitet

Sot janë bërë 10,163 vaksina antiCOVID

8 Prill, 21:08

Aktualitet

Motori del nga rruga, plagosen dy persona në Elbasan! Njëri prej tyre në gjendje të rëndë

8 Prill, 20:32

Aktualitet

Vaksinohen 25.720 mësues, Manastirliu: Çdo ditë e më shpejt po i afrohem ditës në fund të tunelit

8 Prill, 19:08

Aktualitet

Nisin fluturimet esenciale në Rinas, Xhafaj: Krizë e sajuar politikisht për të futur vendin në terr! Po punohet me kontrollorë të huaj, kush s'u përfshi në këtë grevë të rinisë punën

8 Prill, 18:53

Aktualitet

Sot 317 raste të reja dhe 6 humbje jete nga COVID-19

8 Prill, 18:05